

## Gugash Magani: Na duhen perforcime urgjente

nga AlbaniaSoccer

E shtunë, 21 Dhjetor 2013 17:15

---



Trajneri i Tiranës Gugash Magani, u vu përballë ish skuadres së tij Teuta për herë të parë këtë sezon. "Ishte ndeshje emocionuese, por unë tek Teuta kam kaluar mirë, ashtu siç kam kaluar tek çdo skuadër që kam qënë. Këtë e ka thënë edhe Presidenti. Sot siç e patëm djemte u munduan për mungon finalizimi. Kur erdha tek Tirana, kërkoja 5-6 përforcime, të cilat janë imediate edhe pse djemte që kam në dispozicion janë të mirë. Unë nuk dua të largoj asnjë nga skuadra sepse ata janë të gjithë me kontratë dhe nuk është normale të heq, por na duhen përforcime patjetër, sepse jemi në gjendje shumë të vështirë dhe nga Kategoria Bien 4 skuadra. Lodhja pas ndeshjes së gjatë shtesë në mesjavë për Kupe u ndje edhe në takimin e sotëm ku siç e patëm lamë 2 pike. Përforcimet e Janarit duhen bërë urgjent dhe personalisht mund të them se preferoj lojtarë shqiptarë, pasi është më e lehtë sesa të huajt që të ingranosh në sistem", përfundoi Magani